



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal off Kaçanik
01Nr. 08-320-8306/14
Kaçanik, 31.03.2014

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVA KOMUNA E KACANIKUT OPSTINA KACANIK	
Data	02.04/14
Vendi	Kaçanik
Numri	01Nr. 08-320-8306/14
Shtojcë	

Në bazë të nenit 17 (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 6.2 dhe 61.1 të Statutit të Komunës, të nenit 5 lidhur me nenin 17 alinea 2 e Rregullores së Komunës 01Nr. 16- 27192/12 Për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 31.03.2014, mori këtë:

V E N D I M

LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË DREJTORISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE PYLLTARISË

I.

Me këtë Vendim lejohen mjete financiare nga pozicioni i Subvencioneve dhe Transfereve në shumë **70.000 €** (Shtatëdhjetëmijë euro) për realizimin e projekteve të drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

II.

Shuma e mjeteve të lejuara si në pikën I. të këtij Vendimi, destinohen për realizimin e këtyre projekteve, sipas kësaj shpërndarje:

1. Projekti për subvencionim të fermerëve me Farë Misri dhe Pleh Mineral, **15.000 €**,
2. Projekti për mbështetje të bletarëve me Koshere Bletësh, **10.000 €**,
3. Projekti për subvencionim të fermerëve me Farë Gruri dhe Pleh Mineral, **15.000 €**,
4. Projekti për eliminimin e Qenve Endacak, **6000 €**,
5. Projekti për organizimin e Panairit të Gjdhit "Kaçaniku 2014", **2.500 €**, dhe
6. Projekti i subvencionimit të fermerëve me Serra, me sipërfaqe prej 50m², **21.500 €**.

III.

Obligohet Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë të bëjë implementimin e projekteve, sipas projekteve detaje të cilat gjenden në drejtori.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen : Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

IV.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë,
3. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, dhe
4. Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi